

UDHËZIM
Nr. 12, datë 24.10.2012

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 338/3, DATË 10.3.2006 “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”, TË
NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 35 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 2471, datë 6.12.2006 “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 338/3, datë 10.3.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Programimi i fondeve mbështetet në numrin e popullsisë gjithsej, numrin e familjeve, vlerësimin e varfërisë dhe numrin e familjeve në NE, strukturën e anëtarëve të familjes (anëtarët në moshë pune, mbi moshë pune dhe nën moshë pune); personat që kanë statusin e jetimit; numrin e familjeve që kanë fëmijë të lindur njëherësh, si: trinjakë, katërnjakë apo pesënjakë, viktimat të trafikimit, viktimat të dhunës në familje, si dhe fëmijë në familje kujdestare.

Në bazë të dokumentacionit, vlerësohen edhe të ardhurat që llogariten sipas koeficientëve nga pasuria, toka, blegtoia.

Fondet e nevojshme për ndihmën ekonomike për bashkinë/komunën përlllogariten në bazë të treguesve të mësipërm dhe të masës së përfitimit për secilën kategori përfituesish, sipas Mod. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera